

FUNKSIONI 106: MBROJTJA SOCIALE

Programi 10661: Strehimi Social

Përmbajtja

HYRJE	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 10661	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT	5
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT	8
4. TË DHËNA MBI PROGRAMIN	10
5. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2023- 2025	12

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 10661

Vështrim i përgjithshëm		
Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
10661	Strehimi social	• Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; • Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; • Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; • Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë; • Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;

Një ndër funksionet e Bashkisë Shkodër është strehimi social. Bashkia Shkodër synon harmonizimin dhe bashkërendimin më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë.

Ligji i ri për strehimin social ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative përmënyratesigurimit,tëshpërndarjes,administrimitdheplanifikimittëprogramevesocialepërstrehimin,meqëllimkrijiminemundësivepërstrehimtëpërshtatshëmdhetëpërballueshëm,dukeumbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore.

Bashkia Shkodër ka zbatuar disa programe të strehimit social dhe ka zbatuar disa projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të strehimit të komuniteteve në nevojë, siç janë:

- Banesat Sociale me Qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6 (ish-konvikti i shkollës Pyjore) që kanë si qëllim të ofrojnë strehim të përshtatshëm për jetimët e dalë nga institucionet rezidenciale si dhe familje njëprindërore në kushte të vështira social-konomike.
- Subvencioni i interesave të kredisë si një instrument financiar për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, me anë të të cilit familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese.
- Granti i menjëhershëm është një tjetër instrument financiar për lehtësimin e zbatimit të BKU, me anë të të cilit familjet që kanë përfituar banesa me kosto të ulët dhe që i përkasin disa kategorive të përcaktuar në ligj, kanë të drejtë të përfitojnë një grant të menjëhershëm për të lehtësuar pagesën e kredisë.
- Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë është një instrument financiar i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.
- Banesat Sociale për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom, ku do të përfitojnë familje të komunitetit rom, të cilët do të mbështeten për fuqizimin dhe integrimin e tyre social.
- Banesat Sociale me Qira, të ndërtuaratë përshtatura për strehim pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare, ku do të përfitojnë 28 familje në nevojë për strehim.

Programet e strehimit dhe projektet që synojnë përmirësimin e kushteve të strehimit, bashkëfinancohen me jo më pak se 20% të vlerës nga bashkia Shkodër.

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2023-2025								
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia								
Programi	10661	Strehim Social						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	0	0	0	0	0	0	0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	0	0	0	0	0	0	0
Korente								
Mallra dhe Shërbime	602	784	115	2,216	1,917	1,150	1,150	1,150
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	0	3,747	8,756	13,103	8,000	8,000	8,000
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	230	0	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	69,149	50,574	28,027	15,388	0	0	0
TOTALI		69,933	54,436	38,999	30,408	9,150	9,150	9,150

Komente

Programi 10661: Strehimi social ka si burim financimit transfertën e kushtezuar dhe të ardhurat e bashkisë. Të ardhurat e programit zene mesatarisht 65.6 % ndërsa shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga transferi i pakushtezuar dhe të ardhurat e tjera mesatarisht me 34.4 %. Shpenzimet korrente zene 100 % të shpenzimeve totale për 3 vitet e PBA 2023-2025.

2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm		2023-2025			
Programi	10661	Strehimi social			
Përshkrimi i Programit		• Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; • Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; • Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; • Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë; • Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira;			
1	Qëllimi i Politikës së Programit	Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social : Numri personave të mbështetur me strehim social sipas kategorive (Ndryshimi vjetor në numër)	291	50	50	0
	Rritja e të ardhurave nga shërbimi i banesave sociale të bashkisë: Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale (Rritja në %)	1864%	0%	0%	0%

1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social : Numri personave të mbështetur me strehim social sipas kategorive (Ndryshimi vjetor në numër)	291	50	50	0
	Numri i banesave sociale funksionale si pjesë e fondit të banesave sociale me qira të bashkisë	107	120	130	130
	Rritja e të ardhurave nga shërbimi i banesave sociale të bashkisë: Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale (Rritja në %)	1864%	0%	0%	0%
	Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social ; Numri i individe/familjeve qe perfitojne banesa sociale me qira (Ndryshimi vjetor në numër)	134	10	10	0
	Numri i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	6	6	6	6
	Numri i zonave të vlerësuara për zhvillim dhe pajisje me infrastrukturë me qëllim strehimin;	2	2	2	2
	Numr i aplikimeve për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese;	7	7	7	7
2	Qëllimi i Politikës së Programit	Administrimi i programeve të strehimit social.			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social : Numri i familjeve që përfitojnë bonus strehime, (merren para kesh për një kontratë qeraje) (Ndryshimi vjetor në numër)	27	11	5	5
	Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social : Numri i familjeve perfituese nga subvencionimi i interesave të kredive nga shteti për familjet në nevojë (kredi të buta për shtëpi) (Ndryshimi vjetor në numër);	-25	-10	-5	-5
2.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë,përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Numri i aplikimeve për subvencionim qiraje (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar)	0%	0%	0%	0%
	Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social : Numri i familjeve që përfitojnë bonus strehime, (merren para kesh për një kontratë qeraje) (Ndryshimi vjetor në numer)	27	11	5	5
	Numri i aplikimeve për subvencionimin e interesave të kredisë (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar)	0%	0%	0%	0%

Rritja e përfituesve të programeve të strehimit social : Numri i familjeve perfituese nga subvencionimi i interesave të kredive nga shteti për familjet në nevojë (kredi të buta për shtëpi) (Ndryshimi vjetor në numër);	-25	-10	-5	-5
Numri i aplikimeve për banesa sociale me qira (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar)	0%	0%	0%	0%

Kryetari i NJQV		Koordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022

3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm			2023-2025		
Programi		10661	Strehimi social		
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmiresimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë			
1.1.A.	Produkti	Persona të mbështetur me strehim social në banesa sociale me qira			
	Kodi i Projektit	P10661.Q1.O1.A1			
	Përshkrimi i Produktit:	Persona të mbështetur me strehim social në banesa sociale me qira			
	Njësia Matëse	Numër familjesh			
		2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	150	160	170	170
	Kosto totale (në mijë lekë)	1,150	1,150	1,150	1,150
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	7.7	7.2	6.8	6.8
	Ndryshimi në % i Sasisë		6.7%	6.3%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		-6.3%	-5.9%	0.0%
1.1.B.	Produkti	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të paforizuara			
	Kodi i Projektit	P10661.Q1.O1.A2			
	Përshkrimi i Produktit:	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të paforizuara			
	Njësia Matëse	Numri i Projekteve			
		2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	6	6	6	6
	Kosto totale (në mijë lekë)				
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!

	Ndryshimi në % i koston për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
2.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm			
2.1.A.	Produkti	Persona të mbështetur me subvencionim qiraje në tregun e lire dhe perfitues të subvencionimit të interesave të kredisë për banesa me kosto të ulët			
	Kodi i Projektit	P10661.Q2.O1.A1			
	Përshkrimi i Produktit:	Subvencionimi i qirase në tregun e lire dhe subvencionimi i interesave të kredisë për banesa me kosto të ulët			
	Njësia Matëse	Numri i personave			
		2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	54	65	70	75
	Kosto totale (në mijë lekë)	7,100	8,000	8,000	8,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	131.5	123.1	114.3	106.7
	Ndryshimi në % i Sasisë		20.4%	7.7%	7.1%
	Ndryshimi në % i koston totale		12.7%	0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		-6.4%	-7.1%	-6.7%
Kryetari i NJQV		Koordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022

4. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 4 Të dhënat e Programit

Të Dhëna Bazë mbi Programin									
Programi 10661	Të Përgjithshme	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të dhënat e programit/ Vitet									
Numri personave të mbështetur me strehim social		50	60	35	159	450	500	550	550
Numri i banesave sociale funksionale si pjesë e fondit të banesave sociale me qira të bashkisë		24	24	24	51	107	120	130	130
Numri i individe/familjeve që përfitojne banesa sociale me qira		0	0	16	16	150	160	170	170
Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale (mijë lekë)					118	2,308	2,308	2,308	2,308
Numri i aplikimeve për subvencionim qiraje (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar)		5	38	163	55	55	55	55	55
Numri i aplikimeve për subvencionimin e interesave të kredisë (raporti në % viti korent kundrejt vitit të kaluar)		15	20	123	100	100	100	100	100
Numri i familjeve që përfitojnë bonus strehime, (merren para kesh për një kontratë qiraje)					27	54	65	70	75
Numri i aplikimeve për banesa sociale me qira		7	11	40	78	78	78	78	78
Numri i aplikimeve gjithsej në vite për strehim social		2,006	2,075	2,401	3,289	2,867	3,100	3,333	3,333
Numri i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,		1	1	2	4	6	6	6	6

Numri i zonave të vlerësuara për zhvillim dhe pajisje me infrastrukturë me qëllim strehimin;		1	1	1	2	2	2	2
Numri i aplikimeve për permiresimin e kushteve të banesave ekzistuese;				7	7	7	7	7
Numri i familjeve perfituese nga subvencionimi i interesave të kredive nga shteti për familjet në nevojë (kredi të buta për shtëpi)			104	75	50	40	35	30

5. Projektet e planifikuara për PBA 2023- 2025

Tabela 5 Emërtimet e aktiviteteve

Projekte të planifikuara				000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Institucioni Likuidues	Buxheti 2023	Buxheti 2024	Buxheti 2025
P10661.Q1.O1.A1 Administrimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë.	Bashkia Shkodër	1,150	1,150	1,150
P10661.Q1.O1.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit	Bashkia Shkodër	-	-	-
P10661.Q2.O1.A1 Zbatimi i programeve të strehimit social	Bashkia Shkodër	8,000	8,000	8,000
Total		9,150	9,150	9,150

Nr. 1	P10661.Q1.O1.A1 Administrimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë.	Funksioni 10: Mbrojtja Sociale N/Funksioni 106: Strehimi Social Programi 10661 Strehimi Social
--------------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Që nga viti 2016 Bashkia ka krijuar fondin publik të banesave sociale me qira, përmes zbatimit të projekteve të ndryshme të bashkëfinancuara nga ministria e linjës, kryesisht përmes përshtatjes të objekteve të dala jashtë funksionit por edhe me ndërtim të ri, duke aplikuar sipas Thirrjeve për projekte të shpalluara nga ministria çdo vit.

Konkretisht kemi realizuar:

Programi i strehimit në banesa sociale me qira:

1. Ndërtimin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare «Për Familjen» nr. 6 (përshtatje për strehim social të ish-konviktit të shkollës Pyjore), që synon përmirësimin e kushteve të banimit për jetimet e dalë nga institucionet rezidenciale dhe familjet njëprindërore në kushte të vështira social-ekonomike.
 - Për zbatimin e këtij programi të strehimit social, në përbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat synojnë të rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e këtyre banesave.
 - Me vendim nr. 27 datë 26.6.2020, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banësve Sociale me Qira pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr. 6", është miratuar Rregullorja për funksionimin e këtij programi të strehimit, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet përfituesve dhe strukturës përgjegjëse administruese. Gjithashtu, me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.14 datë 26.2.2020 "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale tek ish-konvikti i shkollës Pyjore", janë miratuar vlerat e qirasë mujore sipas sipërfaqeve të apartamenteve në këtë strukturë.
 - Për këtë program kanë aplikuar 30 aplikues, nga të cilët 16 aplikues kanë plotësuar kriteret për këtë program dhe janë kualifikuar në fazën e dytë (një aplikues është tërhequr nga procesi). Aplikuesit e tjerë janë orientuar drejt programeve të tjera të strehimit që Bashkia Shkodër po zbaton. Lista e përfituesve pasi është miratuar në Komisionin e Strehimit të Bashkisë, është dërguar për miratim pranë Këshillit Bashkiak. Me vendim të Këshillit Bashkiak, është miratuar dhe një listë shtesë prej 5 individësh/familje përfituese të këtij programi.
 - Në zbatim të këtij projekti janë rikonstruktuar 24 apartamente, të cilët do të jenë në dispozicion të këtij programi strehimi të VKM nr. 384 datë 12.6.2019 "Për caktimin e dokumentacionit për të përfutur sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore".
2. Një tjetër projekt i zbatuar për ngritjen e banesave sociale me qira është Projekti i strehimit social "Godina sociale", Rikonstruktion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontenier 1+1 dhe 2+1)", ku janë ndërtuar 27 banesa sociale me qira, të cilat synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom.
 - Me VKB nr. 29, datë 3.6.2021 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e "Rregullores së është miratuar lista e përfituesve dhe si dhe është miratuar Rregullorja e Administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom" në zbatim të projekteve: Rikonstruktion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina me kontenier 1+1 dhe 2+1)" si dhe VKB nr. 31 datë 3.6.2021 "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom". Për këtë program kanë aplikuar 25 individë/familje, nga të cilët janë miratuar 23 individë/familje përfitues. Të gjithë përfituesit e miratuar kanë nënshkruar Kontratën e Qirasë me bashkinë Shkodër, kanë realizuar procedurën e ndryshimit të emrit të përdoruesit në kontratën me OSHEE dhe UKSH dhe janë në processistemimipranë këtyre godinave.

Në Rregulloret e miratuara për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale, pronë e bashkisë Shkodër janë miratuar strukturat përgjegjëse administruese përkatëse, që kanë në përberje 1 administrator dhe punonjës social.

3. Një tjetër projekt i zbatuar për rikonstruktionin e objekteve ekzistuese në pronësi të bashkisë, të dala jashtë funksionit dhe përshtatja e tyre për banesa sociale me qira është: "Rikonstruktion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruktion i ish-Konviktit të Shkollës Veterinare). Bashkia e Shkodrës është shpallur fituese e projektit të strehimit për vitin 2020 me vlerë totale 95,174,998 lekë, njoftuar me shkresë nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Projekti i paraqitur nga Bashkia Shkodër për financim i përket programit të strehimit "Banesë sociale me qira, rikonstruktion" dhe adreson problematikën shumë të rëndë të banimit në Bashkinë Shkodër të familjeve me probleme social-ekonomike.
 - Godina e ish-konviktit të shkollës Veterinare është dëmtuar shumë nga zjarri i rënë, veçanërisht pjesa perëndimore e katit +1 të godinës, në të cilën gjysma e çatisë ishte krejtësisht e dëmtuar dhe godina në këtë pjesë ishte e zbuluar, duke u bërë rrezik për apartamentet e tjera të katit 0 të godinës. Gjithashtu, dëmtimi i plotë nga zjarri i 5 apartamenteve ka sjellë që 5 familje me 28 anëtarë të jenë të pastrehë dhe aktualisht janë të vendosur në konviktin e shkollës së mesme Industriale.
 - Meqenëse gjatë viteve familjet e akomoduar në këtë godinë kanë kryer shtesa dhe modifikime të objektit duke sjellë ndryshime strukturore të rëndësishme, rikonstrukcioni i godinës sipas projektit solli një sistemim thelbësor të godinës, hyrjes, ambienteve të përbashkëta, hapësirave të brendshme dhe të jashtme, duke krijuar kushtet bazë të një banese banimi me 28 apartamente.

- Në këtë projekt janë ndërtuar në total 28 apartamente. Në total janë parashikuar të strehohen rreth 146 banorë. - Me vendim të Këshillit Bashkiak, janë miratuar si përfitues 26 individë/familje. - Është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak "Përcaktimi i qirasë sociale për përfituesit e këtij programi". - Për Banesat sociale me qira, që janë rikonstruktuar pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare, është hartuar dhe miratuar Rregullorja për administrimin dhe mirëmbajtjen, që përmban dhe strukturën përgjegjëse administruese. - Aktualisht, jemi në proces nënshkrimi të Kontratave të Qirasë ndërmjet përfituesve dhe bashkisë Shkodër. Pas përfundimit të procedurës së plotë, do të realizohet sipas kushteve të kontratës, ndryshimi i emrit të përdoruesit në kontratën me OSHEE dhe UKSH.							
Programi i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë:							
1. Në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social",përcaktohet: "1.Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.2. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira".							
Bashkia Shkodër do të vlerësojë në vazhdimësi nivelin e të ardhurave të përfituesve në raport me vlerën e qirasë për të siguruar që qiraja është e përballueshme për përfituesit.Në rastet kur vlera e qirasë zë një përqindje më të madhe se ajo e përcaktuar në ligj në raport me nivelin e të ardhurave të individit/familjes, do të raportojmë pranë Këshillit Bashkiak me synim përjashtimin e mundshëm nga pagesa e qirasë të individëve/familjeve që kanë të ardhura të pamjaftueshme.							
Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabël që do të strehohen në këto banesa sociale.							
ii. Synimi i projektit							
- Sigurimi i strehimit të përshtatshëm të jetimëve që pas moshës 18-vjeçare largohen nga institucionet e përkujdesit rezidencial. - Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familje një prindërore në kushte të vështira social ekonomike. - Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familje të komunitetit rom. - Përmirësimi i kushteve të banimit për individë dhe familje që banojnë në banesa jashtë standarteve në fuqi. - Mbështetja e përfituesvetë banesave sociale me qira në përmirësimin e jetesës dhe socializimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të qendrës komunitare ose përmes punonjësit social. - Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të familjeve romë që banojnë në territorin e Bashkisë Shkodër. - Orientimin drejt programeve të tjera të strehimit në momentin që përfituesit arrijnë një fuqizim ekonomik dhe social të konsiderueshëm. - Ofrimi i strehimit të rasteve në kushtet e emergjencës për strehim sipas parashikimeve ligjore.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
- Ngritja e strukturës përgjegjëse administruese për 3 projektet e banesave sociale me qira sipas rregulloreve të miratuara. - Ofrimi i strehimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm për përkutesit. - Subvencionimi i qirasë për individë/familje pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta. - Fuqizimi social-ekonomik i përfituesve me synim arrijnë e autonomisë përmes funksionit të Qendrës Komunitare «Për Familjen» nr. 6 dhe figurës profesionale të punonjësit social. - Bashkëpunime dhe marrëveshja me OJF, institucione publike, biznes privat, në mbështetje të përmirësimit dhe integritetit social të përfituesve të këtij projekti.							
b) Rezultatet që prisni							
- Kushte të banimit të përmirësuar për komunitetin që banon në territorin e Bashkisë Shkodër. - Cilësi e jetës dhe shëndet i përmirësuar i komunitetit. - Fuqizim social-ekonomik i familjeve të pafavorizuara. - Infrastrukturë e përmirësuar dhe rikualifikim i zonës ku shtrihet projekti.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Jetimët që jetojnë në konvikte Jetimët që dalin nga institucionet pas moshës 18-vjeçare Familjet njëprindërore, gratë kryefamiljare që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike Familje të komunitetit rom Familje që jetojnë në kushte të vështira jashtë standardeve të miratuara Komuniteti.				Bashkia Shkodër OJF Ministria e Financës dhe Ekonomisë Institucionet publike në territor			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ujë	250			250		

A.2	Energji elektrike	300			300		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	300			300		
A.4	Blerje materiale elektrike,	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike	100			100		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
	Shuma	1,150			1,150		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ujë	250			250		
A.2	Energji elektrike	300			300		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	300			300		
A.4	Blerje materiale elektrike.	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike	100			100		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
	Shuma	1,150			1,150		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ujë	250			250		
A.2	Energji elektrike	300			300		
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	300			300		
A.4	Blerje materiale elektrike,	100			100		
A.5	Blerje materiale hidraulike	100			100		
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100		
	Shuma	1,150			1,150		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar – Dhjetor 2023, 2024, 2025		-Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. -Ministria e Financës dhe Ekonomisë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.2	P10661.Q1.O1.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit	Funksioni 10: Mbrojtja Sociale N/Funksioni 106: Strehimi Social Programi 10661 Strehimi Social
-------------	---	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:	
i. Situata	
Me synim ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës, Bashkia e Shkodrës ka marrë një sërë nismash të rëndësishme: Gjatë vitit 2016 Bashkia e Shkodrës ka aplikuar dhe fituar pranë MZHU projektin për rikonstruksionin e 9 banesave të komunitetit egjiptian duke siguruar kështu financimin e duhur për rikonstruksionin e këtyre banesave në lagjen përtej urës së Bunës me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit të këtyre banorëve, gjithashtu është aplikuar për rikonstruksionin e 35 banesave të tjera pranë këtij komuniteti, por ky projekt nuk është miratuar. Është vënë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave një sipërfaqe prej 66,000 m2 truall për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët. Gjatë vitit 2017 kanë përfunduar ndërhyrjet për sigurimin e ujit të pishëm dhe administrimin e ujërave të zeza. Përfutjes të këtij shërbimi janë 150 familje të komunitetit përtej urës së Bunës. Një tjetër projekt i bashkëfinancuar gjatë vitit 2016-2017 me ministrinë e linjës në kuadër të rikonstruksionit të banesave në pronësi të bashkisë që kanë dalë nga funksionin dhe janë adaptuar për strehim janë Banesat sociale me qira pranë QKF nr. 6 ku tashmë janë të strehuar 21 përfutjes që i përkasin kategorisë së jetimëve të dalë nga institucione dhe familje njëprindërore në kushte të vështira social-ekonomike. Pranë këtyre banesave funksionon qendra komunitare nr. 6 që ka si qëllim fuqizimin dhe integrimin e përfutjesve që vijnë nga kategori vulnerabël. Gjatë vitit 2018 – 2019 është siguruar financimi, ka filluar zbatimi dhe është relizuar projekti: “Përmirësim i shërbimeve bazë në lagjen Mark Lula (Ndërtimrrjeti i ujëtpijshëm). Nga zbatimi i këtijprojektitkanë përfutuarrrreth 3000 banorë të lagjes “Mar Lula”, ngatë cilët 100 janë pjesë e komunitetitrom. Gjatë vitit 2019- 2020është aplikuarpranë Ministrisë së linjësdshtëzbatuar projekti “Godinasociale, Shkodër”, që synonpërmirësimin e kushteve të banimitpër 27 familjetë komunitetit rom, projekt i cili ka përfunduar dhe shumë shpejt do të akomodohen familjet përfutuese sipas listës së miratuar mevendim të këshillit bashkiak. Gjithashtu pranë këtyre banesave do të ketë staf psiko social që do të punojë me familjet për fuqizimin dhe integrimin e tyre. Bashkia e Shkodrës ka zbatuar projektin “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksion i ish-konviktit të shkollës Veterinare). Ky projekt me vlerë 95,174,998 lekë është kualifikuar fitues në kuadër të Thirrjes për aplikim për fondet për strehimin për vitin 2020, njoftuar me shkresë nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020 të Ministrisë sëFinancave dhe Ekonomisë dhe përfundon në fund të vitit 2022. Rikonstruksioni parashikonte ndryshime strukturore dhe një sistemim tërësor të godinës si dhe ndërtimin e 28 apartamenteve nga të cilët 12 janë apartamente 1+1 me sipërfaqe30-35m² dhe 16 janë apartamente 2+1 me sipërfaqe 55-60m², duke krijuar mundësi që të shtohet numri i familjeve përfutuese në nevojë. Bashkëfinancimi i bashkisë Shkodër në zbatim të Udhëzimit nr 31 datë 18.11.2019 «Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfutimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit» të Ministrisë për projektet e strehimit shkon deri në 20%. Bashkia Shkodër ka aplikuar edhe për dy projekte të tjera që synojnë adaptimin e godinave në pronësi të bashkisë të dala jashtë funksionit dhe kalimin në fondin publik të banesave sociale me qira. Konkretisht bëhet fjalë për projektin për rikonstruksionin e godinës prane konviktit Arben broci, projekt i cili nuk mori miratimin e ministrisë dhe projekti i paraqitur për financim në vitin 2022 për shtesë kati në godinën e rikonstruktuar si banesa sociale me qira pranë ish konviktit të shkollës veterinare. As ky projekt nuk është miratuar nga ministria e linjës. Në vijim, synohet që të projektohen dhe të aplikohen për fonde në ministrinë e linjës ose në bashkëpunim me sektorin privat për projekte që kanë lidhje me programin e zhvillimit të zonës me qëllim strehimin, pajisja e truallit me infrastrukturë në zona të palegalizuara e që nuk mund të legalizohen, në zonat e vjetra industriale jofunksionale etj. Evidentimi i banesave private në rrezik shembje, dhe përgatitja e projekteve për përshtatjen dhe përmirësimin e kushteve të banesave për familje dhe individë të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.	
ii. Synimi i projektit	
• Përmirësimi i kushteve të banimit dhe të jetesës së komuniteteve të pafavorizuara në Bashkinë e Shkodrës. • Projektimin e realizimin e ndërhyrjeve për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, pajisja e truallit me infrastrukturë. • Rikonstruksion i objekteve në pronësi të bashkisë të dala jashtë funksionit dhe kalimi në fondin e banesave sociale me qira. • Përmirësimi i kushteve të banimit për familje dhe individë që banojnë në banesa në rrezik shembje. • Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom/egjiptianë që jetojnë në banesa të papërshtatshme. • Ndërturja e programeve sociale të strehimit dhe shërbimeve sociale	
iii. Aktivitetet kryesore të projektit	

- Evidentim dhe vlerësim i nevojave për zhvillim të zonës me qëllim strehimin. - Projektimi dhe aplikim për sigurim të fondeve për financimin e projekteve për zhvillim të zonës me qëllim strehimin dhe/ose pajisja e truallit me infrastrukturë. - Projektimi i ndërhyrjeve për rikonstruksion i objekteve në pronësi të bashkisë të dala jashtë funksioni dhe kalimi në fondin e banesave sociale me qira. - Evidentim dhe vlerësim i nevojave për ngritjen e i strehave të përkoshme për komunitete në nevojë. - Projektim, sigurim i financimit dhe ngritja e strehave të përkoshme për komunitete në nevojë. - Evidentimi i banesave në rrezik shembje, përgatitja e projekteve teknike dhe sigurimi i financimit për përmirësimin të kushteve të banesave.						
b) Rezultatet që prisni						
- Objekte në pronësi të Bashkisë Shkodër të dala jashtë funksionit janë pjesë e fondit të banesave sociale me qira. - Shtim i fondit të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë. - Streha të përkoshme të ngritura për komunitete në nevojë. - Kushte të përmirësuara të banimit të individëve / familje që banojnë në banesa në rrezik shembje. - Zona të zhvilluara për strehim, truall i pajisur me infrastrukturë për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara. - Fuqizimi social ekonomik të individëve/familjeve të pafavorizuara.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Komuniteti i Bashkisë Shkodër Komuniteti rom/ egjiptian.			Ministria e linjës Bashkia OJF, Donatorë, Qendra komunitare "Për familjen"			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1						
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Janar – Dhjetor 2023, 2024, 2025			Stafi i drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Drejtoria e Studimit Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Donatorë Ministria e Financës dhe Ekonomisë Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër			

Nr. 3	P10661.Q2.O1.A1 Zbatimi i programeve të strehimit social	Funksioni 10: Mbrojtja Sociale N/Funksioni 106: Strehimi Social Programi 10661 Strehimi Social
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Me miratimin e kuadrit të ri ligjor të strehimit social, gjatë vitit 2020, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social.		
Bashkia Shkodër po zbaton disa programe të strehimit social siç janë: Subvencionimi i interesave të kredisë, Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë, si dhe programin e banesave sociale me qira si tek Banesat sociale me qira pranë QKF nr. 6, banesat sociale për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom si dhe banesat sociale të ngritura nga adaptimi për strehim social të ish-godinës së konviktit të shkollës Veterinare.		
Në zbatim të VKM nr. 384 datë 12.6.2019 janë ndjekur procedurat e parashikuara për zbatimin e programeve të strehimit social. Informacioni në lidhje me programet e strehimit në zbatim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu, specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë i gatshëm për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, ku çdo ditë pranë zyrës me një ndalesë, janë bërë aplikime nga qytetarët. Janë miratuar nga këshilli bashkiak çdo vit sistemet e pikëzimit për programet që zbatohen nga Bashkia Shkodër.		
Kuotat e vëna në dispozicion nga ministria e linjës për instrumentin financiar në zbatim të programit “Subvencionimi i interesave të kredisë” për vitin 2020 është 100. Aktualisht, meqënëse nuk është ezauruar kjo kuotë, janë miratuar 3 lista përfituesish, që përmbajnë dhe listën e rezervë të përfituesve, të cilat u janë dërguar institucioneve financiare për t'u trajtuar dhe për të lidhur kontratat e kredisë. Sipas informacioneve që kemi deri tani , janë lidhur rreth 40 kontrata me përfitues që do të përfitojnë interesa të lehtësuar të kredisë. Gjithashtu, për vitin 2022 është miratuar lista e 123 përfituesve në Komisionin e Strehimit,për të përfituar nga Subvencionimi e qirasë në tregun e lirë me fond të bashkëfinancuar nga ministria e linjës, nga ku pas depozitimit të kontratës së qirasë përfitojnë subvencionim përfitues.		
Duke marrë parasysh rritjen e numrit të aplikimeve për banesat sociale me qira dhe subvencionim të qirasë në treg të lirë, për vitin 2023 është parashikuar si vlerë bashkëfinancimi 4,000 lekë për subvencionimin e qirasë në treg të lirë dhe 6,000 lekë si transfertë nga ministria e linjës.		
Janë miratuar dhe janë sistemuar 21 përfitues pranë Banesave Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6“(ish-konvikti i shkollës Pyjore), që i përkasin kategorisë së jetimëve të dalë nga institucionet dhe familje njëprindërore, të cilët gjithashtu përfitojnë shërbime sociale prane QKF ngritur për këtë qëllim. Sipas VKB nr 11 datë 26.2.2021 “Për miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për përfituesit e banesave sociale me qira pranë QKF nr. 6 dhe përjashtimin nga pagesa e qirasë së përfituesve të subvencionimi në raport me nivelin e të ardhurave”, është miratuar masa e subvencionit sipas nivelit të ardhurave dhe përjashtimi nga subvencionimi të atyre përfituesve me nivel shumë të ulët të të ardhurave. Meqënëse banesat sociale me qira janë pronësi të bashkisë, subvencionimi i qirasë për përfituesit shmanget duge përjashtuar përfituesit nga detyrimi i qirasë për atë pjesë që kalon aftësitë përballuese.		
Është miratuar lista prej 23 përfituesish për banesat sociale me qira të ngritura me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom.		
Është zbatuar programi i banesave sociale me qira të ngritura nga rikonstruksioni i ish-konviktit të shkollës Veterinare dhe adaptimi për strehim social. Është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak lista me 26 individë/familje përfituese që do të strehohen në godina.		
Një nga sfidat kryesore gjatë zbatimit të programeve të strehimit social mbetet administrimi dhe mirëmenaxhimii i programeve të strehimit social.		
ii. Synimi i projektit		
• Përmirësimi i kushteve të strehimit për familjet e pastreha nëpërmjet harmonizimit dhe bashkërendimit më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë. • Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për zbatimin e projekteve të strehimit social me qëllim zbutjen e kësaj plage sociale. • Vlerësimi i inventarit të aseteve e pronave të paluajtshme të Bashkisë së Shkodrës me objektiv kthimin e këtyre aseteve në banesa sociale. • Përmirësimi i kushteve të jetesës për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë blerjen e shtëpive në treg të lirë, duke përfshirë kryesisht familjet në vështirësi të theksuara socio-ekonomike. • Ofrimi i alternativave për një strehim të përballueshëm e të përshtatshëm. • Administrimi i të dhënave aktuale e të sakta me qëllim hartimin e politikave efikase.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
▪ Shpallja e thirrjes për aplikim për programet që do të zbatohen dhe janë financuar. ▪ Plotësim i formularëve të aplikimit sipas programeve të strehimit. ▪ Vlerësim dhe kualifikim i kërkesave sipas shtimit të pikëzimit. ▪ Njoftim i aplikuesve që nuk kualifikohen për plotësim të të metave.		

- Njoftim i aplikuesve të kualifikuar për plotësim të dokumentacionit. - Shqyrtim dhe verikim të aplikimeve nga Komisioni i strehimit. - Dërgim per miratim të listës përfundimtare të përfituesve pranë K.B. - Përcaktimi i listës së aplikuesve për strehim social sipas llojeve të aplikimit dhe të mundësive për të përfituar, banesë - Përgatitjen e programit afat mesëm të strehimit social në Bashkinë e Shkodrës. - Forcimi i kapaciteteve në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave e strehimit social. - Përmirësim i qasjes në strehim të grupeve vulnerabël.						
b) Rezultatet që prisni						
- Shërbim i strehimit social i konsoliduar dhe efektiv. - Sigurimi i strehimit nëpërmjet zgjerimit e orientimit të programeve të strehimit social që zbatohen. - Informacion i plotë mbi nevojat për strehim social në Bashkinë e Shkodrës. - Strehimi social pjesë e shërbimeve sociale dhe e mbështetjes së familjeve në vështirësi ekonomike e sociale. - Lista e përfituesve të programeve të strehimit të zbatuar në bashki të miratuar në Këshillin Bashkiak - Gjendja e pronave dhe aseteve publike të vlerësuara dhe sipas mundësive të projektuara për strehim social.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Individë dhe familje në vështirësi social-ekonomike që nuk kanë të ardhura të sigurojnë strehim të përshtatshëm.			Bashkia e Shkodrës Donatorë vendas e të huaj, OJF, Ministria Financës dhe Ekonomisë Enti Kombëtar i Banesave.			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	8,000				8,000
	Shuma	8,000				8,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	8,000				8,000
	Shuma	8,000				8,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Subvencionimi i qirasë të banesave në tregun e lirë	8,000				8,000
	Shuma	8,000				8,000
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar – Dhjetor 2023, 2024, 2025		Drejtoria e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik Ministria e Financës dhe Ekonomisë Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				